



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI VENDOR RINOR

Datë 17/02/2026

PROCES VERBAL

Takim në kuadër të miratimit të planit Vendor Rinor Përmet

Vendi : Bashkia Përmet

Ora : 14:00

Tema e takimit : Analizimi i projekt - draftit për planin e rinisë, ndryshime dhe shkëmbim idesh.

I mbajtur sot më datë 17 Shkurt, pranë ambienteve të Bashkisë Përmet. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin Drejtoresh e Projekteve Klaudia Ciko, Përfaqësuese e Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim znj. Loreta Mamani, Ekspertja e Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim znj. Albana Allushaj, Drejtoresh e Zhvillimit ekonomik znj. Etleva Myftari, Përgjegjëse e finances znj. Ela Naqe, Administratorja e qytetit znj. Kristjana Ibrahim, Drejtoresh kabineti znj. Anxhela Dauti, Punonjëse protokolli znj. Rudina Osmani dhe Specialist i Turizmit dhe Rinisë znj. Kristiana Thodhori.

Mbledhja u hap nga Ekspertja e Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim znj. Albana Allushaj, e cila falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin dhe theksoi rëndësinë e përfshirjes së të gjithë sektorëve dhe të rinjve në procesin e hartimit të politikave vendore.

Gjatë prezantimit të projekt-draftit u paraqitën elementët kryesorë të planit, përfshirë vizionin dhe misionin e dokumentit, objektivat, fushat prioritare të ndërhyrjes si arsimi dhe formimi profesional, punësimi dhe sipërmarrja rinore, pjesëmarrja dhe aktivizmi qytetar, kultura, sporti, dhe përfshirja sociale. U prezantuan gjithashtu masat e planifikuara, afatet kohore të zbatimit, mekanizmat e monitorimit dhe indikatorët e performancës, si dhe parashikimet e përgjithshme buxhetore.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua çështjes së buxhetimit të planit. Pjesëmarrësit sugjeruan që dokumenti të përfshijë një buxhetim më të hollësishëm dhe të detajuar për secilën masë dhe aktivitet të parashikuar, duke specifikuar kostot përkatëse, burimet e financimit dhe ndarjen vjetore të fondeve. U theksua se një buxhetim më i detajuar do të rriste transparencën, do të lehtësonte monitorimin e zbatimit dhe do të garantonte një planifikim më realist dhe të zbatueshëm.



Në përfundim, u dakordësua që Shoqata MKEZH do të shqyrtojë me kujdes të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë mbledhjes dhe do t'i konsiderojë ato në procesin e përmirësimit të projekt-draftit. U theksua angazhimi për reflektimin dhe integrimin e propozimeve të vlefshme, veçanërisht në lidhje me detajimin e buxhetimit, me qëllim që dokumenti përfundimtar të jetë sa më gjithëpërfshirës, realist dhe i zbatueshëm. Pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin në fazat e mëtejshme të finalizimit dhe zbatimit të Planit Vendor të Rinisë.

Takimi u mbyll më **15:00**.

Specialisti i Turizmit dhe Rinisë

Kristiana Thodhori

Anëtar të Këshillit Vendor Rinor Përmet



Foto nga takimi:

